



Nr 3499/Prot  
11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Elbasan më 30/07/2021

**VENDIM**

Nr 72 datë 29/07/2021.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin QERSHOR 88 familje me fond 278.860 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 3498/1 Prot

Elbasan më 30/07/2021

**VENDIM**

Nr. 73 datë 29/07/2021

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2021**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara për muajin **QERSHOR 2021** gjithsej 229 familje me një fond prej 1.361.816 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja







REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 3500/11 prot

Elbasan me 30/07/2021

V E N D I M

Nr. 74 /datë 29/07/2021

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës /07/2021 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar dhe vendimin e “Komisionit të vlerësimit të nevojave dhe vendosjes në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale dhe kujdestarisë”, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

V E N D O S I

I. Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe si më poshtë:

1. I moshuri Z. Mihal Siko Dukoli i datëlindjes 10.11.1945, vendbanimi Elbasan, lagjia ” Haxhias ” me nr. ID E51110018U.
2. I moshuri Ismail Zenun Berati i datëlindjes 04.11.1946, vendbanimi Elbasan, lagjia ”Brigada 17 Sulmuese” me nr. ID E61104002F.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Qendres Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Hektor Çiftja**





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3501/Prot.  
11

Datë 30.07.2021

VENDIM

NR. 75, DATË 29.07.2021

MBI

“TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2022-2024”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë \_\_\_\_ . 07. 2021, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm, të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimin nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”,

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2022-2024, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR  
Klajd GRIPSHI

KRYETAR  
Hektor ÇIFTJA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3508 / Prot.

Elbasan më 30 .7.2021

VENDIM

Nr. 76 datë 29.7.2021

***“Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .7.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”;
- VKM nr.384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

**VENDOSI:**

1) Të miratojë ngritjen e Komisionit të Strehimit, me përbërje si mëposhtë:

- Kryetar - Zv/kryetari i Bashkisë;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Aseteve, Pronave dhe Strehimit;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Buxhetit;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Financës;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë Juridike;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Kujdesit Social;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit;
- Anëtar - Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të Njësive Adm. / Lagjeve;
- Anëtar - Përfaqësues i Drejtorisë së Informacionit;

2) Pjesëmarrjen, si dëgjues në takimet e këtij komisioni, të përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse me aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Elbasan, si mëposhtë:

- *Përfaqësues të shoqatave të jetimëve;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të grave;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të PAN;*
- *Përfaqësues të të persekutuarve politikë;*
- *Përfaqësues të komunitetit, shoqatave në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve rome dhe egjiptiane;*
- *Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve;*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3538/11 Prot.

Elbasan më 30.7.2021

VENDIM

Nr. 77 datë 29.7.2021

***“Për miratimin e formularit të kërkesës për të përfitur nga programet e strehimit social”***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_7.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”;
- VKM nr.384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

**VENDOSI:**

- 1) Të miratojë formularin e kërkesës për të përfitur nga programet e strehimit social, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Informacionit në Bashkinë Elbasan.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi

KRYETARI  
Hektor Çiftja







5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 3504 / Prot

Elbasan më 30/07 /2021

VENDIM

Nr. 78 datë 29 /07/2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT TE AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT  
BASHKIAK ELBASAN

Këshilli Bashkiak Elbasan në mbledhjen e tij të datës 29.07.2021 në mbështetje Ligjit nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetë qeverisjes Vendore”

**VENDOSI:**

1. Të miratoj Planin e Aektiviteteve të Këshillit Bashkiak Elbasan, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Bashkiak, Sekretari Këshillit Bashkiak, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë më njohjen, respektimin dhe zbatimin e këtij plani.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd GRIPSHI

KRYETARI  
Hektor ÇIFTJA





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 3570/prot

Elbasan më 30.07.2021

**V E N D I M**

Nr. 79/datë 29/07/2021

***Për miratimin e zbatimit të marveshjes ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Forumit të Gruas Elbasan (FGE) në kuadër të projektit “Akses i përmirësuar në shërbime emergjence për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna në Qarkun e Elbasanit”, financuar nga UNDP dhe qeveria Suedeze në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale per periudhen Shtator 2021-Qershor 2022.***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_.7.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar “***Për miratimin e zbatimit të marveshjes ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Forumit të Gruas Elbasan (FGE) në kuadër të projektit “Akses i përmirësuar në shërbime emergjence për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna në Qarkun e Elbasanit”, financuar nga UNDP dhe qeveria Suedeze në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhen Shtator 2021-Qershor 2022.*** mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në R.Sh.” neni 36 dhe në ligjin Nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunes në mardhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018 ) neni 7 pika 4,

**V E N D O S I**

- 1 Të miratojë zbatimin e Marveshjes ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Forumit të Gruas Elbasan (FGE) në kuadër të projektit “***Akses i përmirësuar në shërbime emergjence për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna në Qarkun e Elbasanit***”, financuar nga UNDP dhe qeveria Suedeze në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale per periudhen Shtator 2021-Qershor 2022.
- 2 Të miratojë kontributin e bashkisë Elbasan në sigurimin e ambjenteve për Strehezen.



3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Hektor Çiftja**

